



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor

Prokuroria Themelore Mitrovicë

AD.PTHM.nr.2/25

Prokuroria Themelore Mitrovicë – U.D. Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore Mitrovicë Njazi Rexha, duke vendosur në çështjen disiplinore sipas Ankesës së parashtruar nga ankuesit “I.I.V.S” dhe M. H. përmes përfaqësuesit të tyre av.A. S. me datë 22.01.2025 ndaj Prokurorit të Shtetit A. P., pas vlerësimit të ankesës së parashtruar dhe pranimit të deklarates nga Prokurori i Shtetit A. P., në mbështetje të nenit 9 par.1 nën par.1.5 dhe par.6 të Ligjit Nr.06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, nenit 6 par.1, par.4 dhe nenit 7 par.1, par.3 nën par.3.2 dhe par.4 të Rregullores 05/2019 për procedurën disiplinore të prokurorëve, me datë 26.02.2025 merr këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar Ankesa disiplinore e datës 22.01.2025 e regjistruar me numër të Lëndës AD.PTHM.nr.2/25 e parashtruar nga ankuesit “I.I.V.S” dhe M. H. përmes përfaqësuesit të tyre av.A. S. kundër Prokurorit të Shtetit A. P., me pretendime se ka bërë shkelje të natyrës disiplinore të detyrës së prokurorit, duke aluduar në dispozitën e nenit 6 par.2 nën par.2.1 dhe 2.5 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve për mos ndërmarrje të veprimeve në çështjen penale PP.II.nr... ku si të pandehur janë V. H. dhe A. H. për shkak të veprave penale Veprimtaria e pandërgjegjshme ekonomike nga neni 285 par.2 lidhur me nenin 31 dhe 81 të KPRK-së, Keqpërdorimi i autorizimeve ekonomike nga neni 290 par.1 nën par.1.1 lidhur me nenin 31 dhe 81 të KPRK-së, Komunikimi i paautorizuar i sekretit tregtar nga neni 292 par.1 lidhur me nenin 31 dhe 81 të KPRK-së dhe të pandehurit A. H. për veprën penale Mashtrimi ose dëmtimi i kreditorëve apo debitorëve nga neni 289 par.1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, ku si palë të dëmtuara janë ankuesit “I.I.V.S” dhe M. H., për arsye se nuk ka të bëjë me ndonjë shkelje disiplinore.

A r s y e t i m

Zyra e U.D. Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore Mitrovicë, përmes zyrës së Prokurorit të Shtetit me datën 29.01.2025 ka pranuar Ankesën për mosndërmarrje të veprimeve në Lëndën PP.II.nr... e parashtruar nga ankuesit “I.I.V.S” dhe M. H. përmes përfaqësuesit të tyre av.A. S. me datë 22.01.2025, ndaj Prokurorit të Shtetit A. P. me pretendime se ka bërë shkelje të natyrës disiplinore që i referohet shkeljes së detyrës së prokurorit sipas nenit 6 par.2 nën par.2.1 dhe 2.5 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Në Ankesën e parashtruar palët ankuese pretendojnë se me datë 15.10.2019 kanë paraqitur kallëzim penal ndaj A. dhe V. H. nga Mitrovica dhe për shkak se prokurori i çështjes nuk kishte ndërmarrë veprime hetimore, të dëmtuarit kanë dorëzuar pranë organeve kompetente parashtrës/kërkesa të vazhdueshme për ndërmarrjen e veprimeve konkrete procedurale. Palët me datë 21.10.2024 përmes e-mail e kishin theksuar faktin se tanimë kishin kaluar 5 vite nga dorëzimi i kallëzimit penal ndërsa ende nuk ka një vendim në këtë fazë të procedurës penale dhe kanë paraqitur ankesë me datë 22.11.2024 për mosndërmarrje të veprimeve pranë Prokurorisë së Apelit në përputhje me nenin 84 par.8 të KPP-së. Prokuroria e Apelit – Departamenti i Përgjithshëm me datë 11.12.2024 ka njoftuar parashtruesin e kërkesës se me Aktvendimin AKAP/II.nr.. të datës 11.12.2024 është aprovuar ankesa lidhur me mosndërmarrjen e hetimeve me udhëzimin për prokurorin e shtetit të Prokurorisë Themelore Mitrovicë për ndërmarrjen e veprimeve hetimore. Palët në ankesë kanë theksuar se për shkak

se nga momenti i dorëzimit të kallëzimit penal e deri në ndërmarrjen e veprimeve të lartcekura kanë kaluar 5 vite, kurse nga veprimi i fundit i Prokurorisë Themelore Mitrovicë i datës 12.03.2024 kanë kaluar më shumë se 10 muaj dhe nga vendimi i Prokurorisë së Apelit kanë kaluar 1 muaj dhe ende nuk ka veprime konkrete procedurale nga Prokurori kompetent për zbardhjen e rastit.

Pas analizimit të ankesës në cilësinë e Autoritetit Kompetent kemi kërkuar nga Prokurori i Shtetit A. P. një deklaratë në përputhje me nenin 6 par.4 të Rregullores Nr.05/2019 për procedurën disiplinore të prokurorëve.

Prokurori i Shtetit A. P. me datë 06.02.2025 ka dhënë Deklaratë lidhur me ankesën e parashtruar nga palët e lartcekura dhe e njëjta ka theksuar faktin se me Lëndën PP.II.nr... është ngarkuar si prokuror e rastit me datë 06.06.2023 me rastin e transferimit të përkohshëm nga Prokuroria Themelore Ferizaj dhe së bashku me këtë rast është ngarkuar edhe me 600 rastet të tjera ku rreth 100 raste kanë qenë me hetime të filluara dhe si të tilla kanë qenë urgjente pasi që ka pasur rrezik të kalimit të afatit të hetimeve. Lidhur me rastin me datë 29.02.2024 ka autorizuar Policinë e Kosovës dhe me datë 18.03.2024 e ka pranuar raportin mbi zbatimin e autorizimit ashtu që me datë 05.03.2024 është intervistuar dëshmitari M. H., me datë 08.03.2024 është intervistuar i dyshuari A. H. si dhe janë bashkangjitur shkresa të tjera të kërkuara dhe të sjella nga palët. Prokurori i Shtetit A. P. ka theksuar në deklaratë se pas marrjes së Aktvendimit të Prokurorisë së Apelit me datë 09.01.2025, me datë 27.01.2025 është marrë Aktvendim për fillimin e hetimeve kurse palët i dëmtuari – dëshmitari M. H. dhe përfaqësuesi i tij av.A. .S. përmes telefonit dhe e-mail janë ftuar për caktimin e seancës për marrjen e deklaratës në procedurë paraprake me datë 07.03.2025 në ora 10:00 të cilët e kanë konfirmuar pjesëmarrjen. Prokurori i Shtetit A. P. në deklaratë ka theksuar se pretendimet për mos ndërmarrje të veprimeve nuk qëndrojnë pasi që janë ndërmarrë veprime në këtë çështje por duke pasur parasysh numrin e madh të lëndëve të ngarkuara, numrin e lëndëve urgjente për trajtim, pjesëmarrjen në shqyrtime ku vetëm tre prokuror i mbulojnë tri gjykata me gjithsej 6 gjyqtarë, numrin e madh të rasteve me masa për sigurinë e pranisë së të pandehurit në procedurë nuk ka asnjë qëllim që lëndët të mos trajtohen me kohë por vetëm koha e pakët në dispozicion për trajtim duke e ditur ngarkesën dhe gjendjen në Prokurorinë Themelore Mitrovicë.

Pas shikimit dhe analizimit të pretendimeve të paraqitura nga parashtruesi janë ndërmarrë veprime dhe nga Prokurori i Shtetit A. P. dhe janë siguruar shkresat e Lëndës PP.II.nr...

Duke i analizuar dhe shtjelluar në mënyrë të plotë të gjitha rrethanat e rastit, pretendimet e palës ankuese, shkresat e Lëndës PP.II.nr... po ashtu Deklaratën e Prokurorisë A. P., rezulton se në këtë rast nuk kemi të bëjmë me shkelje të natyrës disiplinore nga Prokurori i Shtetit A. P. të aluduar nga pala ankuese në nenin 6 par.2 nën par.2.1 dhe 2.5 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve për mos ndërmarrje të veprimeve në çështjen penale PP.II.nr....

Autoritetit Kompetent me rastin e shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se Prokurori i Shtetit A. P. është ngarkuar me Lëndën PP.II.nr... me datë 06.06.2023 pasi që është transferuar nga Prokuroria Themelore Ferizaj në Prokurorinë Themelore Mitrovicë, andaj edhe pse kanë kaluar pesë vite që nga paraqitja e kallëzimit penal në vitin 2019 nga pala ankuese çështja e mos ndërmarrjes së veprimeve deri me datë 06.06.2023 nuk mund t' i atribuohet në këtë rast Prokurorit të Shtetit A. P. pasi që e njëjta ashtu siç u theksua më lart është ngarkuar me Lëndën me datë 06.06.2023 dhe e njëjta 8 muaj pasi që është ngarkuar me lëndën ka ndërmarrë veprime duke e autorizuar Policinë e Kosovës ku me datë 18.03.2024 ka pranuar raportin nga Policia mbi zbatimin e autorizimit.

Për më tepër Prokurori i Shtetit A. P. pas pranimit të Aktvendimit nga Prokuroria e Apelit me datën 09.01.2025 me qëllim të zbatimit të këtij Aktvendimit ka marrë Aktvendimin mbi fillimin

e hetimeve me datë 27.01.2025 ku dhe i ka njoftuar palët përmes telefonit dhe email-it për marrjen e deklaratës në procedurë paraprake me datë 07.03.2025.

Autoriteti Kompetent në këtë rast vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet e palës ankuese se Prokurori i Shtetit A. P. ka bërë shkelje të natyrës disiplinore nga neni 6 par.2 nën par.2.1 të Ligjit për përgjegjësi disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve si rezultat i mos ndërmarrjes së veprimeve nga Prokurori i Shtetit A. P..

Autoriteti Kompetent po ashtu vlerëson se në këtë rast nuk kemi të bëjmë me shkelje të natyrës disiplinore nga neni 6 par.2 nën par.2.5 të Ligjit për përgjegjësi disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve nga Prokurori i Shtetit A. P., për arsye se Prokurori i Shtetit A. P. në rastin PP.II.nr... ka ndërmarrë veprime të nevojshme hetimore procedurale me qëllim që të merren parasysh të drejtat e palëve të dëmtuara të cilët kanë paraqitur kallëzimin penal në këtë rast ankuesit "I.I.V.S" dhe M. H., për faktin se e njëjta i ka njoftuar palët përmes telefonit dhe email-it konkretisht të dëmtuarin – dëshmitarin M. H. dhe përfaqësuesin e tij av.A. S. për caktimin e seancës për marrjen e deklaratës në procedurë paraprake me datë 07.03.2025 në ora 10:00 të cilët e kanë konfirmuar pjesëmarrjen.

Autoriteti Kompetent vlerëson se Prokurori i Shtetit A. P. në rastin PP.II.nr... ka ndërmarrë veprime të nevojshme hetimore procedurale me qëllim të ndriçimit të rastit duke ushtruar funksionin prokurorial bazuar në kompetencat, detyrat dhe përgjegjësit e prokurorit të shtetit me qëllim që të marrë parasysh të drejtat e palëve të dëmtuara të cilat në këtë rast kanë paraqitur kallëzim penal.

Andaj me qenë se pretendimet e palës ankuese nuk ndërlidhen me shkelje të natyrës disiplinore nga Prokurori i Shtetit A. P. sipas nenit 6 par.2 nën par.2.1 dhe 2.5 të Ligjit për përgjegjësi disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, për arsyet e cekura më lart bazuar në nenin 7 par.3 nën par.3.2 të Rregullores 05/2019 për procedurën disiplinore të prokurorëve ankesa me karakter disiplinor e parashtruar nga ankuesit "I.I.V.S" dhe M. H. përmes përfaqësuesit të tyre av.A. S. me datë 22.01.2025 ndaj Prokurorit të Shtetit A. P. refuzohet si e pa bazuar dhe kjo ankesë konsiderohet e mbyllur A/A.

U.D. KRYEPROKURORI

Njazi Rexha



Një kopje e këtij vendimi dorëzohet:

- 1. Shkresat e Lëndës AD.PTHM.nr.2/25;**
- 2. Palës ankuese;**
- 3. Prokurorit të Shtetit A. P.;**
- 4. Këshillit Prokurorial të Kosovës.**